

Nr. 7/10 Prot.
Dt. 24.03.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 41871 Prot.

Tiranë, më 18 3 .2020

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Nr. 29 Datë 18 3 2020

PËR

ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "ALBAFILM" SHA TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme Nr. 5, datë 20.1.2020 "Për përgatitjen e dokumentacionit të zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë "Albafilm" sha, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Albafilm" sha Tiranë;

VENDOSA:

1. Kapitali themeltar të zvogëlohet për vlerën 89,212,000 lekë, i barabartë me 89,212 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 902,320,000 lekë, i barabartë me 902,320 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Albafilm" sha Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Anila Denaj